

Titulli i lëndës: Gjuhësi kontrastive

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës shqipe
Titulli i lëndës:	Gjuhësi kontrastive
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti I, semestri I (MA)
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Kadire Binaj - Ejupi
Të dhënat kontaktuese:	kadire.binaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kursi gjuhësi kontrastive ofron njohuri rreth kontrastimit të gjuhës shqipe me një gjuhë tjetër. Temat që do të diskutohen kanë të bëjnë me definimin e Gjuhësisë kontrastive, me bazën psikologjike të saj, me komponentet gjuhësore të gjuhësisë kontrastive, me makro dhe mikrostrukturën e gjuhësisë kontrastive si dhe me ndikimin pedagogjik të saj. Çështjet teorike do të kombinohen me probleme praktike, të cilave studentët duhet t'u gjejnë zgjidhje në të dyja gjuhët.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është që ta shpjegojë gjuhësinë kontrastive si një qasje të përgjithshme të hulumtimit të gjuhës, veçanërisht hulumtimit të realizuar në fusha të caktuara të gjuhësisë së aplikuar, siç janë përkthimi dhe mësimdhënia e gjuhës së huaj. Dallimet strukturore në mes të dy gjuhëve (në rastin konkret anglishtes dhe shqipes dhe anasjelltas) si dhe dallimet e tjera që paraqesin vështirësi në mësimin e gjuhës së huaj, do të trajtohen në këtë kurs.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- t'i identifikojë dhe t'i shpjegojë nocionet dhe termat që kanë të bëjnë me gjuhësinë kontrastive në përgjithësi;
- t'i diskutojë fushat më problemore strukturore dhe funksionale ndërmjet shqipes e anglishtes (ose ndonjë gjuhe tjetër) nën dritën e studimeve kontrastive;
- ta bëjë një kontrastim të një dukurie të caktuar gjuhësore strukturalisht, funksionalisht dhe semantikisht, duke u nisur nga njëra gjuhë ose tjetra.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediary			
Konsultime me mësimdhënësin	12 min	15	3
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Total			113 orë 113:25= 4,52 5 ECTS

Metodat e mësimdhënies:

Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që realizohen me punë në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.

Studentët janë të obliguar t'i shkruajnë dy punime seminari siç është shpjeguar nga profesori në pjesën e metodologjisë së vlerësimit të

	<p>planprogramit mësimor. Të dy punimet janë obligative, nuk do të ketë provim përfundimtar në këtë lëndë.</p> <p>Mësimi do të realizohet në formë diskutimi dhe pyetje-përgjigje në mënyrë që secili student të ketë mundësi të pjesëmarrjes aktive në orë mësimore. Studentët në mënyrë të vazhdueshme do t'i analizojnë tipat e ndryshëm të tekstit dhe do të raportojnë për detyrat e tyre.</p>
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> - Vijimi i rregullt dhe pjesëmarrja aktive 10% - Punim seminari I (Një rishikim kritik mbi analizat e GJK) 30 % - Punimi seminari 2 (Një studim kontrastiv) 60 % - Gjithsej 100 %
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> - James, Carl. 1980. Contrastive Analysis. London, New York: Longman. - Krzeszowski, T. P. 1990. Contrasting Languages: The Scope of Contrastive Linguistics. Berlin, New York: Mouton de Gruyter, etc
Literatura shtesë:	Të gjitha punimet kontrastive të disertacioneve të doktoratës dhe të punimeve të masterit, ndërmjet anglishtes e shqipes, të mbrojtura në Fakultetin e Filologjisë.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Gjuhësia kontrastive – përkufizimi
Java 2:	Analiza kontrastive dhe bilinguizmi
Java 3:	Baza psikologjike e analizës kontrastive (hipotezat)
Java 4:	Përbërësit gjuhësorë të analizës kontrastive – nivelet e ndryshme gjuhësore
Java 5:	Modelet gjuhësore të analizës kontrastive
Java 6:	Analiza kontrastive mikrogjuhësore
Java 7:	Analiza kontrastive fonologjike
Java 8:	Analiza kontrastive gramatikore
Java 9:	Leksikologjia kontrastive

Java 10:	Makrolinguistika dhe analiza kontrastive
Java 11:	Analiza tekstore kontrastive
Java 12:	Analiza kontrastive dhe zbatimi i saj pedagogjik
Java 13:	Prezantimi i punimeve të studentëve I
Java 14:	Prezantimi i punimeve të studentëve II
Java 15:	Prezantimi i punimeve të studentëve III

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.